



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2169 Prot.

Tiranë, më 28 . 7 .2022

V E N D I M

Nr. 23, datë 27. 07.2022

Për

miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përherëshëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë në Universitetin e Tiranës”


Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, pika 1, germa “d” dhe në Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, germa “ë”, neni 37 dhe neni 41, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përherëshëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë në Universitetin e Tiranës”.
2. Vendimi i përcillet për zbatim Komisionit të Përherëshëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë dhe për njohje të gjitha njësive përbërëse të Universitetit të Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Artan Hoxha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

RREGULLORE
“PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR
SIGURIMIN E STANDARDEVE TË CILËSISË NË
UNIVERSITETIN E TIRANËS”

Miratuar me Vendimin Nr. 23, datë 27.07.2022

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i rregullave të organizimit, funksionimit të brendshëm dhe vendimmarrjes të Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë të Universitetit të Tiranës (në vijim KPSSC).

Neni 2

Baza ligjore

Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë organizohet dhe funksionon në përputhje me ligjin nr. 80, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe entevë publike", VKM nr. 531, datë 11.09.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", VKM Nr. 783, datë 26.12.2018 "Për vlerësimin e performancës në mësimdhënie të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë, edhe nëpërmjet sondazhit kombëtar të studentëve", aktet e tjera nënligjore në fuqi; Statutin e UT-së, si dhe në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë së UT-së.

Neni 3

Misioni


1. KPSSC-ja ngrihet dhe funksionon në përputhje me misionin për të garantuar cilësinë e brendshme të institucionit si dhe programeve të studimit që ofron, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.
2. Në ushtrimin e misionit të tij, KPSSC-ja përgjigjet përpara Senatit Akademik për politikën e sigurimit të cilësisë, zbatimin e procedurave të menaxhimit të cilësisë dhe të sigurimit të brendshëm të cilësisë, si dhe e këshillon atë për çështjet e cilësisë.

Neni 4

Parimet

Me qëllim vlerësimin dhe garantimin e cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative e financiare të UT-së, KPSSC-ja e bazon veprimtarinë e tij në parimet e mëposhtme:

- a) Garantimin e transparencës, në proceset e vlerësimit të brendshëm të cilësisë;



- b) Bashkëpunimin dhe koordinimin me njësitë kryesore përmes strukturave të sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel njësie si dhe me strukturat e tjera të UT-së;
- c) Vlerësimin e përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të mësuarit me qëllim që të promovohet përgatitja e studentëve interaktivë;
- d) Krijimin dhe promovimin e një kulture të përmirësimit dhe rritjes së vazhdueshme të cilësisë;
- e) Garantimin e ofrimit të programeve të studimit në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe të shoqërisë shqiptare;
- f) Garantimin e pjesëmarrjes së personelit akademik dhe të studentëve në procesin e vetëvlerësimit dhe në përfitimin prej ekspertizës së jashtme për sigurimin e cilësisë.

Neni 5

Fusha e veprimtarisë

1. KPSSC-ja është organi kolegjal i krijuar nga Senati Akademik që vepron në nivel institucioni dhe struktura përgjegjëse për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë si dhe standardet dhe udhëzimet evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.
2. KPSSC është struktura përgjegjëse që ndjek politikat e hartuara nga Senati Akademik për sigurimin e brendshëm të standardeve të cilësisë, zbatimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UT.
3. KPSSC përgjigjet përpara Senatit Akademik për politikën e vlerësimit dhe zbatimin e procedurave të menaxhimit të cilësisë dhe të sigurimit të brendshëm të cilësisë, si dhe i paraqet Senatin akademik mendimin e tij për çështjet e cilësisë.

Neni 6

Përbërja dhe organizimi i KPSSC-së

1. KPSSC-ja është organ kolegjal, i ngritur në nivel institucional, me vendim të Senatit të UT-së, në përputhje me përcaktimet e nenit 41 të Statutit të UT-së.
2. KPSSC-ja përbëhet nga 11 anëtarë, me të paktën nga një përfaqësues nga secili fakultet i UT-së, një përfaqësues nga strukturat e sigurimit të cilësisë në Rektorat, një përfaqësues nga institutet/degët, dhe tre përfaqësues nga studentët.
3. Anëtarët e Komisionit vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rrizgjedhjeje. Anëtarët e Komisionit, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 41, pika 2 të Statutit të UT.
4. Rrjeti për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë përbëhet nga KPSSC-ja dhe përfaqësuesit e sigurimit të standardeve të cilësisë në çdo njësi kryesore.



Neni 7

Drejtimi dhe funksionimi i KPSSC-së

1. KPSSC-ja drejtohet nga Kryetari i cili zgjidhet nga radhët e anëtarëve të Komisionit, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Senatit Akademik.
2. KPSSC-ja mbledhet në mënyrë periodike, çdo herë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kur kërkohet angazhimi i tij.
3. Komisioni mbledhet jo më pak se një herë në tre muaj.
4. Mbledhjet e KPSSC-së thirren, organizohen dhe drejtohen nga kryetari. Kryetari harton rendin e ditës dhe ua njofton atë anëtarëve të komisionit, të paktën tre ditë para zhvillimit të mbledhjes.
5. Thirrja e mbledhjes së KPSSC-së mund të bëhet edhe me kërkesë të 1/3 së anëtarëve të tij.
6. Mbledhja e KPSSC-së realizohet kur janë të pranishëm së paku 2/3 e anëtarëve të tij.
7. KPSSC-ja merr vendime me shumicën e thjeshtë të të gjithë anëtarëve dhe votimi bëhet i hapur.
8. Vendimet nënshkruhen nga kryetari i KPSSC-së dhe i përcillen zyrtarisht Rektorit të UT-së, i cili i përcjell tek strukturat përkatëse të UT-së.

KREU II


VLERËSIMI I BRENDSHËM I CILËSISË

Neni 8

Detyrat e KPSSC-së

Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë kryen këto përgjegjësi:

- a) I propozon Senatit Akademik politikën, procedurat dhe mekanizmat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, mbështetur në legjislacionin në fuqi, Kodin e Cilësisë të Arsimit të Lartë, udhëzimet e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), si dhe standardeve evropiane dhe ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe ia propozon për miratim Senatit Akademik.
- b) Harton planin e zhvillimit institucional për sigurimin e cilësisë, i cili miratohet nga Senati Akademik.
- c) Vlerëson programet e reja që do të ofrohen nga njësitë përkatëse, përpara miratimit të tyre në Senatit Akademik.
- d) Monitoron dhe vlerëson përmes raporteve, zbatimin e standardeve institucionale të cilësisë dhe të programeve të studimit nga institucioni, njësitë kryesore dhe njësitë bazë, të cilat i paraqet përpara Senatit Akademik.
- e) Rivlerëson politikën dhe procedurat e sigurimit të cilësisë dhe i paraqet ndryshimet përkatëse Senatit Akademik;



- f) Ndjekë politikat e hartuara nga Senati Akademik për sigurimin e cilësisë dhe merr masat e duhura për të siguruar zbatimin e vendimeve të tij.
- g) Mbështet dhe monitoron veprimtarinë e komisioneve të vlerësimit të brendshëm në nivel të njësisë kryesore.
- h) Diskuton raportin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë së institucionit dhe ia propozon për miratim Senatit Akademik.
- i) Ofron asistencë për Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të njësive kryesore apo për struktura të tjera të UT-së në lidhje me standardet e cilësisë;
- j) Harton dhe miraton procedurat, kriteret dhe formatet e vlerësimit të cilësisë akademike në UT dhe njësitë kryesore dhe ia propozojnë për miratim Senatit Akademik.
- k) Analizon Raportin e Vlerësimit Institucional, të hartuar nga Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë të UT-së, dhe bën sugjerimet përkatëse për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.
- l) Ofron në bashkëpunim me ASCAL-in apo me agjenci dhe subjekte të tjera, trajnime për standardet e cilësisë me qëllim përmirësimin e tyre dhe rritjen e kapaciteteve institucionale në drejtim të rritjes së cilësisë;
- m) Kryen çdo detyrë tjetër sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin në fuqi në fushën e arsimit të lartë dhe aktet e brendshme rregullatore të UT-së.

Neni 9

Regjistrimi dhe ruajtja e të dhënave

1. Të gjitha të dhënat e grumbulluara në kuadër të vlerësimit institucional dhe të programeve të studimit, duhet të ruhen në arkivën e Rektoratit dhe të njësive kryesore të UT-së.
2. Të dhënat duhet t'i vihet në dispozicion grupeve të vlerësimit, në momentin e realizimit të vlerësimit institucional dhe të programeve të studimit.

Neni 10

Publikimi i rezultateve të vlerësimit

1. Publikimi i rezultateve të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të UT-së, është i detyrueshëm.
2. Raportet vjetore të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm në nivel institucional, publikohen në faqen zyrtare të internetit të UT-së.
3. Për nevoja institucionale, materiale të përgatitura nga KPSSC-ja dhe raporti apo pjesë të caktuara të tij, mund të publikohen në faqen zyrtare të internetit të UT-së.



Dispozita përfundimtare

Neni 11


Për probleme të funksionimit të KPSSC-së, që nuk janë parashikuar në këtë Rregullore, zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e ligjit nr. 8480/1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Senati Akademik i UT-së.

KRYETAR
Prof. Dr. Artan HOXHA

The image shows a circular official stamp of the University of Tirana (UT). The text around the perimeter of the stamp reads "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" at the top and "UNIVERSITETI I TIRANË" at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania. To the right of the stamp, the name "Prof. Dr. Artan HOXHA" is printed, and a handwritten signature in black ink is written over the stamp and the name.